



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 925/prot.
1

Tiranë më 25.5.2018

Lënda: Mendim mbi nenin 24 të projekt marrëveshjes në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane.

Znj. Gelardina PRODANI

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

E nderuar Znj. Prodani,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.10022 Prot., datë 23.05.2018, "Projekt marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane", vlerësohet e hartuar konform ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Referuar nenit 24 të projekt marrëveshjes, me qëllim përshtatjen e përkthimit në gjuhën shqipe me terminologjinë e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë ndryshimin e paragrafit të parë të këtij neni, si më poshtë:

"Transmetimi apo përpunimi i të dhënave personale sipas kësaj marrëveshje do të bëhet në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave të shteteve kontraktuese si dhe legjislacionin ndërkombëtarë të mbrojtjes së të dhënave personale, duke u mbështetur në parashikimet si më poshtë:

- a) *Të dhënat e transmetuara nga institucioni kompetent i njërit shtet kontraktues, duhet të përpunohen sipas qëllimit të kësaj marrëveshje dhe legjislacionit referues të saj. Përpunimi i të dhënave për qëllime të tjera lejohet brenda kornizës legjislative të shtetit marrës, nëse kjo i shërben qëllimeve të sigurimit shoqëror duke përfshirë proceset gjyqësore të lidhura me të.*
- b) *Institucioni kompetent i cili ka transmetuar të dhënat, duhet të sigurojë, që këto të dhëna të jenë të sakta dhe që përmbajtja e tyre ti shërbejë qëllimit të kërkuar. Në*

këtë rast duhet patur parasysh legjislacioni i zbatueshëm që ndalon transmetimin e të dhënave. Nëse konstatohet, që janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të dhëna që nuk duhet të ishin transmetuar, atëherë pa humbur kohë duhet njoftuar institucioni marrës. Institucioni i cili ka marrë këto të dhëna është i detyruar të korrigjojë apo të shkatërrojë ato.

- c) Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen aq gjatë, sa e kërkon qëllimi për të cilin janë transmetuar. Të dhënat nuk lejohen të shkatërrohen, nëse gjatë shkatërrimit të tyre do të çënoheshin interesat legjitime në mbrojtjen e personit në fjalë në fushën e sigurimit shoqëror.
- d) Institucionet të cilat transmetojnë dhe marrin këto të dhëna janë të detyruara, që të dhënat personale të cilat janë transmetuar, të mbrohen nga aksesit i paautorizuar, ndryshimet dhe publikimi i paautorizuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

